



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Nr. 34 Prot.

Tiranë, 30/03/2015

V E N D I M

Nr. 2 datë 30.3 2015

**“PËR ZBATIMIN E DETYRAVE TË CAKTUARA NË MBLEDHJEN E
DATËS 30 MARS 2015 TE KKDM”**

Në zbatim të ligjit nr. 8681, datë 02.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin e mirëmbajtjen e digave e dambave" Komiteti Kombëtar I Digave të Mëdha i krijuar me VKM nr. 745, datë 20. 10.2011, "Për strukturat e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM0) Urdhërit Nr. 268 datë 22.12.2014 Urdhërit Nr.36, datë 12.3.2015 të Kryeministrit dhe Urdhërit Nr 34, 34/1 datë 25. 02.2015 të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës "Për krijimin e e KKDM dhe KTPD" me datën 30.03.2015 u zhvillua mbledhia e rradhës e KKDM.

Në këtë mbledhje morrën pjesë anëtarët e KKDM dhe KTPD me këtë rend dite:

1. Prezantimi i anëtarëve të rinjë të KKDM, KTPD.
2. Informacion mbi inspektimi në digën e Murdharit nga grupi i kontrollit.
3. Shqyrtimi i raporteve Vjetore të paraqitura nga KESH-i, Ministria e Bujqësisë, Bovilla .

Per piken e pare u be prezantimi I anetareve te rij simbas urdhrit 34. urdhrit 34/1 dhe seicili prej anetareve paraqiti aktivitetin e tij.

Informacioni per kontrollin ne digen e Murdharit u paraqit nga kryetari z. Maksim Muci.

Shqyrtimi Raportit Vjetor te KESH u be ne baze te paraqitjes nga z. Arjan Jovani dhe i atij te Ministrise Bujqesise ne baze te paraqitjes nga z. Luan Bregu. Raporti I diges se Bovilles u paraqit nga z. Maksim Muci.

Mbas diskutimeve që u bë nga të gjithë anëtarët , Komiteti Kombëtar I Digave te Medha

VENDOSI

1. Të organizojë një vizitë pune në bashkëpunim me KESH-in, për tu njohur e azhonuar me problematikat e paraqitura në raportin vjetor për shqyrtim në KKDM, e në vecanti për filtrimet në digën e Komanit. Për këtë qëllim të ngrihet një grup pune i përbërë nga anëtar të KKDM, specialistë të fushës përkatëse si më poshtë:

- Inxh Maksim Muci
- Inxh. Dhimiter Vogli
- Dr.Inxh. Kristo Goga
- Inxh. Arjan Jovani
- Inxh. Sotir Mantho
- Inxh. Niko Pojani
- Inxh. Andi Vila

Grupi do njihet ne detaje me problematiken dhe me planin e masave te mara nga KESH per kete problem.

2. KKDM kerkon te beje kujdes lidhur me problematiken, pershtatshmerine dhe njohjen me Ligjin per Ndarjen Administrativo Territoriale te Njesive te Qeverisjes Vendore ne Republiken e Shqiperise Nr.115/2014 dt. 31.07.2014 lidhur me strukturen e njesive te reja qe mund te krijohen dhe qe do kene te bejne me zbatimin e legjislacionit per kontrollin e sigurise se digave e dambave ne vend. Kjo njohje konsiderohet e domosdoshme qe ne rast gjykimi te mund te bejme sugjerimet perkatese ne administraten e larte. Per kete ngarkohen tre anetare te KKDM te cilet kane experience dhe njohje qe te paraqesin nje informacion ne KKDM Brenda dt. 20 prill 2015. Informacioni do kete lidhje me strukturat dhe organizimin e nje menaxhimi integral te sigurise se digave e dambave e ndoshta dhe argjinaturave.

Grupi i punës do te jetë si më poshtë:

- Xhuvanaq Gjylameti Ministria e Brendeshme

- Luan Bregu Ministria Bujqesise
- Sotir Mantho Ekspert

3. Brënda muajit prill të 2015, KKDM do të dërgojë në Këshill të Ministrave raportin përfundimtar për gjëndjen e digave që administrohen nga institucionet përkatëse.
4. Per digen e Buvilles te kerkohet informacioni shtese lidhur me masat per rreshqitjen ne anen perendimore te rezervuarit e cila permendet ne raportin-vjetor.

Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohet SKDM.

KRYETARI i KKDM

Ing. Maksim Muci

